



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.07, datë 18.10.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“KOMPLEKS MAGAZINIMI DHE TREGTIMI I PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE
PENTARISË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Naim Tragaj Group” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks magazinimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe pentarisë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Naim Tragaj Group” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 11, datë 27.02.2019 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Kompleks për grumbullimin, përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, agro-kulturore dhe pentarisë”, me vendndodhje në Spitalë, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Naim Tragaj Group” sh.p.k, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RIMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ



SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 22 / 02 /2024